



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bekim Shabani	26.06.2026	07.07.2026	2026/0414

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.06.2026, OE "" AUTOTRADE " SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0414, kundër Njoftimit mbi Vendimin B58 i publikuar nga Autoritetit Kontraktues me të cilin vendim AK ka anuluar aktivitetit të prokurimit me titull: "URNIZIM ME PJESEVE PER AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUISER 150 TE PK-se" me nr. të prokurimit: "214/30400-25-10109-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur e hapur, lloji i furnizim, me vlerë të parashikuar 500.000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues, dokumentacionin e tenderit dhe shkresat tjera relevante të administruara në këtë procedurë.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 52 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Vendimi i OSHP-së nr.2025/1157

Vendimi i OSHP-së nr.2026/0096.

Pretendimet Ankimore:

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 19.08.2025, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 30.09.2025, ku kanë ofertuar 2 kompani. Me dt.07.11.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i OE "AUTOBUQA" SH.P.K. & GLOBAL Teile L.L.C., ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin se çmimet me të cilat kemi ofertuar, janë çmime më të larta se sa çmimet e tregut. Kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së të lartcekur, ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, e cila na ishte refuzuar nga ana e AK-së, ndërsa pastaj kemi vazhduar me ankesë në OSHP. Në lidhje me ankesën tonë është nxjerr ekspertiza me nr.2025/1157, me dt.11.12.2025, ndërsa me dt.13.02.2026, është nxjerr edhe vendimi i panelit shqyrtues me nr.2025/1157, me të cilin vendim është aprovuar si pjesërisht e bazuar ankesa jonë, ndërsa është anuluar njoftimi i mbi vendimin e AK-së dhe lënda është kthyer në rivlerësim. Pas rivlerësimit autoriteti kontraktues përsëri kishte nxjerr njoftimin mbi vendimin e saj me dt.13.03.2026, ku e kishte anuluar aktivitetin e prokurimit, ndërsa përsëri neve na kishte eliminuar. Kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së të lartcekur, ne përsëri kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues, e cila na ishte refuzuar nga ana e AK-së, ndërsa pastaj kemi vazhduar me ankesë në OSHP. Në lidhje me ankesën tonë është nxjerr ekspertiza me nr.2026/0096, me dt.03.03.2026, ndërsa me dt.31.03.2026, është nxjerr edhe vendimi i panelit shqyrtues me nr.2026/0096, me të cilin vendim është aprovuar si e bazuar ankesa jonë, ndërsa është anuluar njoftimi i mbi vendimin e AK-së dhe lënda është

kthyer në rivlerësim. Tani pas vlerësimit të tretë AK-ja përsëri ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt.12.06.2026, ku e njëjta e ka anuluar përsëri aktivitetin e prokurimit, ndërsa ne jemi eliminuar përsëri me arsyetimin si në vijim:

Sipas nenit 4.1 pikës C të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik cila thotë Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut për artikullin.

Komisioni I ri-vlerësimit me datën 16.04.2026 sqarim nga OE se si ka arritur te këto çmime për artikujt e me poshtum. sepse çmime e dhena nga OE jane shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut për artikullin. e me poshtëm

Me datën 20.04.2026 OE dorëzon sqarime ,por sqarimet e dhëna nga OE nuk janë bindëse për komisionin e rivlerësimit.

Komisioni i rivlerësimit kërkon te behet hulumtimi i tregut për artikujt e me poshtëm.

Pas pranimit te çmime te hulumtuar ne treg nga komisioni për hulumtim te tregut komisioni i rivlerësimit konstaton se çmimet e ofrua nga OE nuk janë çmime reale te tregut sipa hulumtimit te tregut jane çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut për artikullin. e me poshtëm

Pjesa e vlerësimit për këta artikuj do te jete krahasimi ne mes te vleres se parashikuar ,vleres se ofruar nga OE dhe hulumtimi i tregut I bere nga komisioni i caktuar per hulumtim tregut qmim per njesi per artikujt e me poshtum.

OE ka ofruar me çmime shumë here me te larta për artikujt e poshtë shënuar se sa vlera reale e tregut dhe vlera e planifikuara nga ana e AK e cila është caktuar duke u bazuar ne hulumtim te tregut

Po ashtu duke ju referuar edhe interpretimit te KRPP AK ne harmoni te plot me LPP ka kërkuar sqarime gjate fazës se pare te vlerësimit mbi çmimet shumë herë me te larta se sa ato reale ne treg dhe OE ka ofruar vetëm një zbërthim, program te OE por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri tek formulim i këtyre çmimeve

Pjesa A Pozicionet:1, 2, 3, 4, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15,19, 20.

Pjesa B Pozicionet: 23, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 33, 38, 39, 41, 42, 45, 46, 47, 48, 50, 53, 54, 68, 73, 75, 77, 78, 81, 85, 86, 89, 90, 91, 92, 100, 101, 104, 105, 106, 107, 109, 115, 116, 117, 118, 119, 123, 126.

Pjesa C Pozicionet:128, 129, 130, 133, 134, 138, 141, 142, 145, 146, 148, 149, 150, 151, 157, 159, 160.

Andaj oferta juaj refuzohet si e pa pergjegjshme

Fillimisht duhet sqaruar se neve me dt.16.04.2026, na janë kërkuar sqarime shtesë nga ana e AK-së në lidhje me çmimet me të cilat kemi ofertuar, ndërsa ne me dt.20.04.2026, i kemi kthyer përgjigje AK-së ku e kemi sqaruar se çmimet me të cilat kemi ofertuar janë çmime të tregut, ndërsa me përgjigje i kemi bashkangjitur edhe disa fatura të cilat janë lëshuar për klientët tanë, ku e kemi dëshmuar me fakte konkrete se çmimet tona nuk janë çmime të larta por janë çmime të tregut. Ne edhe një herë po e sqarojmë se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë ashtu siç edhe e kemi cekur edhe në kërkesat e kaluara për rishqyrtim dhe ankesat e dorëzuara në OSHP, është i paqëndrueshëm për faktin se ne i kemi dhënë sqarimet e kërkuara autoritetit kontraktues, ku e kemi vërtetuar se çmimet me të cilat kemi ofertuar ne janë çmime të tregut. Për më tepër, në kuadër të sqarimeve të dorëzuara kemi bashkangjitur edhe fatura konkrete të lëshuara për klientët tanë, të cilat dëshmojnë në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme se çmimet tona janë çmime reale të tregut dhe se ato nuk mund të konsiderohen si çmime të larta apo jashtë nivelit të tregut. Për më tepër tani kemi bashkangjitur edhe fatura konkrete të cilat tregojnë qartë se çmimet me të cilat kemi ofertuar janë çmime të tregut dhe nuk janë çmime të larta siç ka pretenduar AK-ja. Në

përgjigjjen tonë e kemi sqaruar se: Për të ju dëshmuar se POLICIA E KOSOVËS, është klient ekskluziv, dhe se gjithmonë merr zbritjet më të mira në treg, për të gjitha pikat e kërkuara, ju kemi bashkangjitur çmimet të cilat mund ti gjeni në sistemet online të TOYOTA, si dhe çmimet të cilat ju janë ofruar me zbritje për POLICINE E KOSOVËS. Ne kemi analizuar ofertën tonë në tërësi, duke u bazuar në listën e pozicioneve të kërkuara dhe në specifikat teknike të secilës pjesë. Gjatë përgatitjes së ofertës janë marrë parasysh të gjithë faktorët relevant që ndikojnë në çmim, përfshirë furnizimin me pjesë origjinale, burimin e tyre përmes kanaleve të autorizuar, si dhe kushtet e tregut për këtë kategori produktesh. Çmimet e ofruara nga ana jonë janë rezultat i një vlerësimi të kujdesshëm dhe janë në përputhje me nivelin real të tregut për pjesë origjinale. Në këtë kuptim, çdo krahasim i çmimeve duhet të bëhet duke marrë për bazë produkte me karakteristika të njëjta, përkatësisht pjesë origjinale me specifika të njëjta teknike. Në rast se dëshironi çmime krahasuese, dhe hulumtimi të jetë sa më i sakte dhe më i drejtë, ju preferojmë të dërgoni kërkesë edhe tek përfaqësuesi i Toyota për pjesë origjinale kudo në rajon apo në botë për pjesët dhe do të vërtetoni që çmimet e ofruara nga ana jonë janë më të lira/ulëta. Për të vërtetuar faktin se çmimet tona nuk janë më të larta se çmimet e tregut, po ju bashkangjesim disa fatura të lëshuara për klientët tanë, përmes të cilave dëshmohet se çmimet me të cilat kemi ofertuar janë në përputhje me çmimet e tregut dhe nuk i tejkalojnë ato, si dhe zbritja për POLICINË E KOSOVËS si klient është ekskluzive sic e kemi cekur". Prandaj ne nuk e kemi të qartë se si ka ardh në përfundim AK-ja se çmimet tona janë më të larta se çmimet e tregut, përderisa çmimet janë dhënë nga prodhuesi ndërsa ne kemi bërë edhe zbritje për autoritetin kontraktues. Njëkohësisht ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar, andaj arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, sepse në rast se ka pasur ende dilema ka mundur të kërkoj sqarime shtesë nga ana e prodhuesit tonë. Po ashtu, AK-ja nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse nuk i ka marrë parasysh faturat e dorëzuara nga ne, të cilat paraqesin dëshmi konkrete të transaksioneve reale me klientët tanë dhe vërtetojnë se çmimet e ofertuara janë në përputhje me çmimet e tregut. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka marr fare parasysh faturat që i kemi lëshuar për klientët tanë ku shihet qartë se çmimet tona të ofertimit nuk janë çmime të larta, prandaj ky veprim i autoritetit kontraktues nuk mund të merret ndryshe përveçse diskriminim i qëllimshëm kundrejt kompanisë tonë. Në lidhje me këtë arsye të eliminimit sqarojmë se nuk ka bazë ligjore dhe nuk ka asnjë mbështetje faktike për shkak se ne me sqarime i kemi ofruar në detaje çmimet e prodhuesit për pajisje origjinale dhe zbritjet të cilat na janë ofruar neve. AK-ja vetëm e cek që kemi ofruar Çmime më të larta se sa çmimet e tregut, mirëpo nuk ka dhënë asnjë argument apo dëshmi se cilat janë çmimet e tregut, prandaj mbi këtë bazë rezulton se arsyeja e eliminimit është e pa bazuar dhe e pa mbështetur në ndonjë dëshmi konkrete por kjo arsye mbetet vetëm në kuadërtë supozimeve të AK-së. Në anën tjetër, ne kemi paraqitur prova konkrete në formën e faturave të lëshuara për

klitentët tanë, të cilat vërtetojnë se çmimet tona janë çmime të zakonshme të tregut dhe se pretendimi i AK-së për çmime të larta nuk mbështetet në asnjë analizë apo dëshmi objektive. Në treg mund të ketë eventalisht çmime më të lira se sa oferta jonë por ato çmime mund të jenë për pjesë jo origjinale, ndërsa për pjesët origjinale të Toyota nuk ka asnjë mundësi të ketë çmime më të lira se sa oferta jonë. Referimi i AK-së në nenin 4.1 pika C të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 nuk përkon me rastin konkret sepse nuk ka asnjë dëshmi që është siguruar autoriteti kontraktues se çmimi i ofruar nga ne është jashtë çmimeve të tregut, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar. Përkundrazi ne e kemi sqaruar dhe dëshmuar se çmimi i ofruar nga ne është çmim real i tregut, ndërsa nëse AK-së ka pasur vullnet për të vërtetuar këtë fakt shumë lehtë ka mundur të verifikojë çmimin tonë duke kërkuar sqarim edhe nga prodhuesi kudo në Evropë apo rajon, mirëpo një vullnet i tillë ka munguar e që neve na bënë të dyshojmë se veprimet e AK-së janë tendencioze në raport me kompaninë tonë, kur kemi parasysh faktin se nuk janë marr parasysh fare as dëshmitë e prezantuara me sqarime shtesë. Duhet cekur fakti se sqarimet e prezantuara nga ana jonë e tregojnë qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa faktin se sqarimet tona janë në harmoni me dispozitat ligjore e ka vërtetuar edhe paneli shqyrtues i OSHP-së, ku i njëjti e ka mbështetur raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, të cilave ja fal besimin e plotë, është gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues e mbështet raportin e ekspertit dhe mbi bazën e rekomandimeve të dhëna në këtë raport ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me pjese për automjetet Toyota Land Cruiser 150 te PK-se me numër të prokurimit 214/30400-25-10109-1-1-1, të anulohet njoftimi për dhenie te kontrates dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim, si dhe AK të veproj në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Ndërsa në ekspertizën e ekspertit shqyrtues të cilës paneli shqyrtues i ka falur besimin, është konstatuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues mendon se pas analizimit të pretendimeve të OE "AUTOTRADE" SH.P.K dhe dokumentacionit të administruar në dosje, vlerëson se çështja e çmimeve nuk mund të trajtohet e ndarë nga natyra e produktit të ofertuar dhe nga autorizimi i prodhuesit.

OE ankues ka argumentuar se çmimet e ofruara janë çmime të tregut për pjesë origjinale Toyota, të mbështetura me dëshmi nga sistemi i prodhuesit dhe me zbritje specifike për Policinë e Kosovës. Në këtë kontekst, vlerësimi i "çmimit të lartë" nga ana e AK-së do të ishte i drejtë vetëm nëse krahasimi është bërë mbi produkte të së njëjtës natyrë – pra pjesë origjinale të autorizuara nga prodhuesi.

Nga ana tjetër kërkesë nga AK Sqarim shtese : te dt 26.12.2025 OE AUTOBUQA SH.P.K, në letrën sqaruese të datës 29.12.2025, ka deklaruar se produktet e tij "krahasohen 90% të njëjta sikur origjinali (si direkt prodhuesi)", duke pranuar në mënyrë të tërthortë se pjesët e ofertuar nuk janë pjesë origjinale të prodhuesit. Kjo deklaratë ka relevancë të drejtpërdrejtë juridike, sepse konfirmon se çmimi i ofertuar prej tij i referohet produkteve alternative (aftermarket), dhe jo produkteve origjinale të autorizuara nga prodhuesi Toyota , dhe po citoi ate çka është shkruar TE DHEN NE SQARIM TE TENDERVE DT 29.12.2025

" P.sh: Në tregun tonë mund të hasni edhe produkte pa firm vetem paketim, qe nuk dihet origjina e as ku prodhohet.

Produktet tona krahasohen 90 % te njeta sikur origjinali (si direkt Prodhuesi) ."

Eksperti Shqyrtues thekson se Në këtë pikë, ndërlihet drejtpërdrejt edhe kërkesa e Dosjes së Tenderit për "Autorizim të lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezervë ose distributori i autorizuar". Për shembull nëse për pozicionin nr. 176 (moduli i airbagut – pjesë kritike me softuer të mbrojtur) kërkohet autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, atëherë pranimi i një autorizimi nga subjekt që nuk ka licencim nga prodhuesi origjinal për prodhimin e atij komponenti bie ndesh me kërkesën formale të dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues mendon se Rrjedhimisht nuk mund të bëhet krahasim i drejtë i çmimeve ndërmjet pjesëve origjinale dhe pjesëve jo-origjinale. Nuk mund të konsiderohet çmim "më i ulët i tregut" një

çmim që i referohet një produkti me standard teknik dhe juridik tjetër.

Nëse OE i rekomanduar vet deklaron se produktet janë 90% të njëjta me origjinalin, atëherë ai pranon se nuk janë produkte origjinale të autorizuara nga prodhuesi.

Në këtë kuptim, eliminimi i OE ankues për çmime të pretenduara si "më të larta se tregu", pa një analizë krahasuese të produkteve të së njëjtës natyrë (origjinale me origjinale), dhe njëkohësisht pranimi i ofertës së OE tjetër që vet deklaron se produktet nuk janë origjinale, krijon trajtim jo të barabartë dhe bie ndesh me nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik lidhur me vlerësimin strikt sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Prandaj, nga analiza e bërë, pretendimi i OE ankues lidhur me çështjen e çmimit në raport me autorizimin e prodhuesit dhe natyrën e pjesëve të ofertuar, rezulton i bazuar.

Kur kemi narasvsh të oitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se autoriteti kontraktues

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues përveç faktit që na ka diskriminuar neve si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit, i njëjti nuk ka respektuar edhe dy vendimet e fundit të OSHP-së, ndërsa në këtë rast konsiderojmë që kemi të bëjmë me mos zbatim të vendimeve të OSHP-së dhe shpërfillje të vendimeve të OSHP-së, prandaj ky veprim bënë pjesë në shkelje të rënda sipas nenit 97.1 pika (h) të RRPP Nr.001/2022. Në këtë rast kemi shkelje edhe të nenit 131 të LPP-së, prandaj kërkojmë nga OSHP, që ti shqiptoj gjobë autoritetit kontraktues dhe të kërkoj revokimin e certifikatës së zyrtarit të prokurimit, pasi që në këtë aktivitet të prokurimit po eliminohe mi për tri herë radhazi me arsyetime krejtësisht të paqëndrueshme dhe të pa mbështetura në dispozita ligjore. Ne edhe një herë do ti bashkangjesim sqarimet të cilat i kemi bërë me rastin e përgjigjjes në sqarime të AK-së, prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të analizohen në detaje të njëjtat dhe pastaj të nxjerret një vendim

konkret në lidhje me ofertën tonë, pasi që me sqarimet të cilat i kemi dhënë, vendimet e OSHP-së dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues është vërtetuar qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Ne me dt.18.06.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se njëta është e pa bazuar, mirëpo në asnjë mënyrë e njëta nuk ka dëshmuar me fakte konkrete të kundërtën e pretendimeve tona ankimore. Në lidhje me pretendimet tona ankimore për shkeljen e neneve 1, 7, 52, 59, 60, 62, 72 të LPP së, neneve 40 dhe 43 të RRPP-së, si dhe mosrespektimin e vendimeve të OSHP-së, AK-ja është arsyetuar se nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore, duke e cekur se të gjithë operatorët ekonomik janë trajtuar në mënyrë të barabartë, se ka kryer rivlerësimin në përputhje me LPP në, se ka kërkuar sqarime nga ne, ka realizuar hulumtim të tregut dhe ka konstatuar se çmimet e ofruara nga OE "AUTOTRADE" janë shumë herë më të larta se çmimet reale të tregut, për çka oferta është konsideruar e papërgjegjshme dhe aktiviteti është anuluar. Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm si në aspektin faktik ashtu edhe në atë ligjor. Fillimisht, AK-ja gjatë gjithë procedurës vetëm pretendon se çmimet tona janë "shumë herë më të larta se çmimet e tregut", mirëpo në asnjë pjesë të vendimit nuk paraqet dëshmi konkrete, analiza krahasuese, oferta referente, katalogë zyrtarë apo dokumente të verifikueshme që do ta mbështesnin këtë pretendim. Nuk është fakt e as argument që AK-ja të deklarojë se ka kryer hulumtim të tregut, pasi që ajo është e obliguar të tregojë konkretisht se cilat kanë qenë burimet e hulumtimit, cilët operatorë janë kontaktuar, cilat kanë qenë çmimet referente dhe si është bërë krahasimi me ofertën tonë. Në mungesë të këtyre të dhënave, pretendimi i AK-së mbetet vetëm një konstatim i përgjithshëm dhe jo një vlerësim objektiv i bazuar në prova konkrete. Për më tepër, AK-ja pretendon se ne nuk kemi ofruar dëshmi bindëse lidhur me çmimet tona, ndërsa injoron plotësisht faktin se me datë 20.04.2026 kemi dorëzuar sqarime të detajuara së bashku me fatura reale të lëshuara për klientët tanë, të cilat dëshmojnë se çmimet e ofruara janë çmime reale të tregut për pjesë origjinale Toyota. Në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk është dhënë asnjë arsyetim pse këto fatura nuk janë pranuar si dëshmi, nuk është analizuar përmbajtja e tyre dhe nuk është kontestuar autenticiteti i tyre. Mosvlerësimi i dëshmimeve të dorëzuara nga ne përbën mangësi serioze në procesin e vlerësimit dhe cenon parimin e trajtimit të drejtë dhe transparent dhe njëkohësisht tregon diskriminimin që po i bëhet kompanisë tonë si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Gjithashtu, AK-ja vazhdon të krahasojë çmimet tona me të ashtuquajturat "çmime të tregut", pa dëshmuar se krahasimi është bërë me pjesë origjinale Toyota me karakteristika identike teknike. Nëse hulumtimi është bazuar në pjesë alternative, zëvendësuese apo jo-origjinale, atëherë një krahasim i tillë është juridikisht dhe teknikisht i papranueshëm, sepse nuk krahasohen produkte të njëta. Po ashtu, është kontradiktore që AK-ja nga njëra anë pranon se ka kërkuar sqarime sipas nenit 72 të LPP-së dhe se ne kemi dorëzuar përgjigje brenda afatit, ndërsa nga ana tjetër nuk i

merr parasysh fare ato pa dhënë ndonjë analizë profesionale apo arsyetim konkret. Nëse AK-ja ka pasur ende paqartësi lidhur me burimin ose nivelin e çmimeve, ajo ka pasur mundësi të kërkojë verifikime shtesë nga prodhuesi, distributori i autorizuar ose burime të tjera zyrtare, por nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të tillë, me apo pa qëllim nuk e dijmë. Lidhur me pretendimin e AK-së se aktiviteti është anuluar për shkak se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme, ky përfundim mbështetet tërësisht në vlerësimin e gabuar se oferta jonë është e papërgjegjshme. Përderisa AK-ja nuk ka arritur të dëshmojë me prova objektive se çmimet tona janë jashtë nivelit të tregut dhe njëkohësisht nuk ka trajtuar dëshmitë tona konkrete, atëherë nuk ekziston bazë ligjore për eliminimin e ofertës sonë dhe rrjedhimisht as për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Në lidhje me pretendimin tonë ankimor se AK-ja nuk ka respektuar vendimet e OSHP-së, AK ja është arsyetuar se nuk ka shkelur nenin 131 të LPP-së, pasi që lëndën e ka kthyer në rivlerësim ashtu siç është kërkuar me vendimet e OSHP-së. Ky arsyetim nuk qëndron, për faktin se edhe pse formalisht AK-ja e ka kthyer lëndën në rivlerësim, në substancë ajo ka vazhduar të mbështetet në të njëjtin arsyetim të mëparshëm për eliminimin tonë, pa adresuar në mënyrë efektive vërejtjet dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues dhe të panelit të OSHP-së. Fakti që pas dy vendimeve të OSHP-së AK-ja ka ardhur përsëri në të njëjtin rezultat, duke mos dhënë prova të reja dhe duke mos trajtuar dëshmitë e paraqitura nga ne, tregon se rivlerësimi nuk është kryer sipas konstatimeve të shënuara në vendimet e OSHP-së. Respektimi i një vendimi të OSHP-së nuk nënkupton vetëm kthimin e lëndës në rivlerësim, por zhvillimin e një rivlerësimi real, objektiv dhe të bazuar në konstatimet e atij vendimi. Në rastin konkret, AK-ja nuk ka dëshmuar se ka eliminuar mangësitë e identifikuar më herët, prandaj pretendimi ynë për moszbatim efektiv të vendimeve të OSHP-së mbetet plotësisht i bazuar. Edhe pas tri rivlerësimeve dhe pas dy vendimeve të OSHP-së, AK-ja po vazhdon ta diskriminojë kompaninë tonë në mënyrë të qëllimshme vetëm që e njëjta të mos rekomandohet për dhënie të kontratës. Duhet theksuar se ne kemi ofertuar me çmim brenda vlerës së parashikuar të kontratës, kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe konkrete në lidhje me çmimet tona, ndërsa përmes sqarimeve shtesë kemi dëshmuar se çmimet e ofruara janë çmime reale të tregut. Për më tepër, kjo është vërtetuar edhe nga eksperti shqyrtues dhe panelishqyrtues i OSHP-së, të cilët dy herë kanë anuluar vendimet e AK-së dhe kanë kthyer lëndën në rivlerësim. Megjithatë, AK-ja vazhdon të nxjerrë vendime për eliminimin tonë pa paraqitur asnjë provë shtesë, pa dhënë arsyeime konkrete dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së. Kjo dëshmon qartë se AK-ja nuk është duke zhvilluar një rivlerësim objektiv të ofertës sonë, por është duke vepruar në mënyrë diskriminuese dhe tendencioze ndaj kompanisë sonë. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-

së. Po ashtu anulimi i këtij tenderi është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43.5 dhe 43.7 të RRPP Nr.001/2022, sepse nuk janë përmbushur asnjëra prej kushteve të përcaktuar në këto dispozita. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, prandaj ky është diskriminim i hapur. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

KRITERET PËR VLERËSIM

--

Kërkesat e përshtatshmërisë: a) Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit – Aneksi 2
b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës	b)Vërtetim nga Administrata Tatimore
c)Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmerise" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës	c)Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar
d)Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se	d)Vërtetimin nga Gjykata Themelore

drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme	
Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga ofertuesi fitues, përpara publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, që do të thotë se ofertuesi do të refuzohet, do të humbasë garancinë e sigurtisë së ofertës dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.	
Përshtatshmëria profesionale a) Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Certifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet të regjistroj përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> a) Kopja e certifikatës të numrit unik.
b) Certifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor)	b) Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor)
c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë, në kohëzgjatje të kontratës)	c) Autorizim i lëshuar nga prodhuesi i pjesëve rezerve ose distributori i autorizuar i pjesëve rezervë (me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë), në kohëzgjatje të kontratës prej 36 muaj.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 700,000.00 €	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> a) OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit ose nga vendi I themelimit
